



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 159

Tiranë – E Mërkurë, 15 Tetor 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 67, datë 22.8.2014	Për licencimin e shoqërisë “Gjurr Rec” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Malla”..... 8145
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 68, datë 22.8.2014	Për licencimin e shoqërisë “Gjurr Rec” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 8145
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 69, datë 22.8.2014	Për kualifikimin e impiantit prodhues të shoqërisë “Gjurr Rec ” sh.p.k. nga HEC “Malla” 8146
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 70, datë 22.8.2014	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Komp. Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike..... 8146
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 71, datë 22.8.2014	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Komp. Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 8147
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 72, datë 22.8.2014	Për fillimin e procedurave për kualifikimin e impianteve prodhuese të shoqërisë “Komp. Energji” sh.p.k. për HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3” si burim i rinovueshem energjie..... 8148
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 73, datë 22.8.2014	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “German 1”, “German 2”, “German 3” dhe “German 4”..... 8149
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 74, datë 22.8.2014	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për HEC-et “German 1”, “German 2”, “German 3” dhe “German 4”..... 8149

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 75, datë 22.8.2014	Për fillimin e procedurave për kualifikimin e impianteve prodhuese të shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k. per HEC-et “German 1”, “German 2”, “German 3” dhe “German 4” si burim i rinovueshëm energjie.....	8150
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 76, datë 22.8.2014	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Emikel” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	8151
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 77, datë 22.8.2014	Për licencimin e shoqërisë “Bistrica 3 Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	8151
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 78, datë 9.9. 2014	Për miratimin e kërkesës së OSHEE sh.a. për kryerjen e investimit në ndërtimin e n/stacionit 110/35/10 në Çorovodë me fuqi të instaluar 25 MVA.....	8152
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 79, datë 9.9.2014	Për licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji ” sh.a. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	8152
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 80, datë 16.9.2014	Për licencimin e shoqërisë “PTA” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.....	8153
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 81, datë 16.9.2014	Për licencimin e shoqërisë “Albanian General Electricity” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.....	8154
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 82, datë 16.9.2014	Për licencimin e shoqërisë “Antix” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.....	8154
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 83, datë 16.9.2014	Për licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	8155
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 84, datë 16.9.2014	Për rinovimin e licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 102, datë 21.12.2009.....	8155
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 85, datë 16.9.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “A&A Group ” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	8156

**VENDIM****Nr. 67, datë 22.8.2014**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“GJURR REC” SHPK NË AKTIVITETIN
E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “MALLA”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”, 5 pika 1 germa “a”, 13 dhe 14 pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Gjurr Rec” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie me fuqi totale 5.455 MW,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Gjurr Rec” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Gjurr Rec” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Malla” me fuqi 5.455 Mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 68, datë 22.8.2014**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“GJURR REC” SHPK NË AKTIVITETIN
E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 5 pika 2, 8 dhe 13, dhe 14 pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gjurr Rec” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Gjurr Rec” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Gjurr Rec” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 69, datë 22.8.2014

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË “GJURR REC” SHPK NGA HEC “MALLA”

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, nenit 3 pika 1 germa “f”, të ligjit nr. 138/2013, datë 2.2.2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”, nenit 9 pika 1 dhe pika 2 germa “a” të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gjurr Rec” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “Malla”, me fuqi totale të instaluar 5.455 MW si burim i rinovueshëm energjie,

KONSTATOJ SE:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Gjurr Rec” sh.p.k., është plotësuar konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, germat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “Gjurr Rec” sh.p.k., për HEC “Malla”, si burim i rinovueshëm energjie, me fuqi totale të instaluar 5.455 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 70, datë 22.8.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KOMP.ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, 5 pika 1 germa “a”, 13 dhe 14 pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Komp.Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në



aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie me fuqi totale 4.21 MW,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Komp. Energji” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar pjesërisht. Është pa plotësuar germa “d”: Vërtetimi që drejtuesit nuk janë përfshirë në një proces penal, është jashtë afatit të përcaktuar në nenin 8, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar pjesërisht. Është pa plotësuar germa “a”: Vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave, është jashtë afatit të përcaktuar në nenin 8, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Komp. Energji” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Hurdhas 1” me fuqi të instaluar 1.71 MW, “Hurdhas 2” me fuqi të instaluar 1.3 MW dhe “Hurdhas 3” me fuqi të instaluar 1.2 MW (me fuqi totale 4.21 MW).

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 71, datë 22.8.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË
“KOMP.ENERGJI” SH.P.K., NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 8 dhe 10 pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Komp. Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Komp. Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar pjesërisht. Është pa plotësuar germa “d”: Vërtetimi që drejtuesit nuk janë përfshirë në një proces penal, është jashtë afatit të përcaktuar në nenin 8, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit,



modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar pjesërisht. Është pa plotësuar germa “a”: Vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave, është jashtë afatit të përcaktuar në nenin 8, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit e plote/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.)

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gerrat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plote/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10 pika 10 dhe neni 11 pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Komp. Energji” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 72, datë 22.8.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUES TË SHOQËRISË “KOMP. ENERGI” SHPK PËR HEC-ET “HURDHAS 1”, “HURDHAS 2” DHE “HURDHAS 3” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “l”, 9 dhe 39, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 3 pika 1 germa “f”, të ligjit nr. 138/2013 “Për burimet e energjive të rinovueshme”, të ndryshuar,

nenit 9, pika 1, dhe 2, germa “a” të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Komp. Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për kualifikimin e impianteve prodhues të shoqërisë “Komp. Energji” sh.p.k. për HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3” me fuqi të instaluar totale 4.21 MW, si burim i rinovueshem energjie,

KONSTATOJ SE:

Aplikimi i shoqërisë “Komp. Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregullores së procedurave të certifikimit, prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gerrat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për kualifikimin e impianteve prodhues të shoqërisë “Komp. Energji” sh.p.k. për HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3” si burim i rinovueshëm energjie me fuqi të instaluar totale 4.21 MW

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 73, datë 22.8.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “SA’GA-
MAT” SHPK, NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC-ET “GERMAN
1”, “GERMAN 2”, “GERMAN 3” DHE
“GERMAN 4”.**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”, 5 pika 1 germa “a”, 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, me fuqi totale 4.98 MW,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me fuqi totale 4.98 MW nga HEC-et “German 1”(me fuqi 1.2 MW), “German 2”(me fuqi 1.680 MW), “German 3”(me fuqi 1.29 MW) dhe “German 4”(me fuqi 0.81 MW).

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 74, datë 22.8.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “SA’GA-
MAT” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR HEC-ET “GERMAN 1”,
“GERMAN 2”, “GERMAN 3” DHE
“GERMAN 4”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 8 dhe 10 pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,



KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 germat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 75, datë 22.8.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUESE TË SHOQËRISË “SA’GA-MAT” SHPK PËR HEC-ET “GERMAN 1”, “GERMAN 2”, “GERMAN 3” DHE “GERMAN 4” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “l”, 9 dhe 39, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 3 pika 1 germa “f”, të ligjit nr. 138/2013 “Për burimet e energjive të rinovueshme”, të ndryshuar, nenit 9, pika 1, dhe 2, germa “a” të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të

prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për kualifikimin e impianteve prodhuese të shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k. për HEC-et “German 1”, “German 2”, “German 3” dhe “German 4”, me fuqi totale 4.98 MW, si burim i rinovueshëm energjie,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE, të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit. Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, germat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për kualifikimin e impianteve prodhues të shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k. për HEC-et “German 1”, “German 2”, “German 3” dhe “German 4”, me fuqi totale 4.98 MW si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 76, datë 22.8.2014**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “EMIKEL”
SHPK, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 8 dhe 10 pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Emikel” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Emikel” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Emikel” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 77, datë 22.8.2014**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“BISTRICA 3 ENERGY” SHPK NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 5 pika 2, 8 dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Bistrica 3 Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Bistrica 3 Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe



pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Bistrica 3 Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 78, datë 9.9. 2014

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË OSHEE SHA PËR KRYERJEN E INVESTIMIT NË NDËRTIMIN E N/STACIONIT 110/35/10 NË ÇOROVODË ME FUQI TË INSTALUAR 25 MVA

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.9.2014 pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për kryerjen e investimit në ndërtimin e një n/stacioni 110/35/10 me fuqi të instaluar 25 MVA, në Çorovodë dhe u njoh me informacionin e përgatitur nga grupi i punës,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i OSHEE sh.a për planin e investimit në ndërtimin e n/stacionit 110/35/10

me fuqi të instaluar 25 MVA në Çorovodë me një vlerë të parashikuar prej 2 200 000 euro është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 13 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”. Ky investim përbën një ndërhyrje të domosdoshme dhe të koordinuar teknikisht dhe në aspektin kohor të ndërtimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e OSHEE sh.a. për kryerjen e investimit në ndërtimin e n/stacionit 110/35/10 në Çorovodë me fuqi të instaluar 25 MVA dhe me vlerë të parashikuar investimi 2 200 000 (dy milionë e dyqind mijë) euro.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrotjtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSHEE sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 79, datë 9.9.2014

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI ” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 8 dhe 10 pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.9.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ayen As Energji” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të



Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 germat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Ayen AS Energji” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM

Nr. 80, datë 16.9.2014

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“PTA” SHPK, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR NJË AFAT 5-VJEÇAR**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 5 pika 2, 8 dhe 13 dhe 14 pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit

të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.9.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “PTA” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “PTA” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “PTA” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

**VENDIM**

Nr. 81, datë 16.9.2014

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBANIAN GENERAL ELEKTRICITY”
SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR NJË
AFAT 5-VJEÇAR**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 5 pika 2, 8 dhe 13 dhe 14 pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.9.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian General Electricity” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Albanian General Electricity” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Albanian General Electricity” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 82, datë 16.9.2014

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ANTIX” SHPK, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR NJË AFAT 5-VJEÇAR**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 5 pika 2, 8 dhe 13 dhe 14 pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.9.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Antix” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Antix” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9



pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Antix” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 83, datë 16.9.2014

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“AYEN AS ENERGJI” SHPK NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31, 8 pika 2, germa “a”, 9 dhe nenit 45 pika “4” dhe 48 pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “P”, 5 pika 1 germa “P”, 13 dhe 14 pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.9.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ayen AS Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në

rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b”, “c”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Ayen AS Energji” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, me një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 84, datë 16.9.2014

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “GSA” SHPK, NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE NR. 102, DATË
21.12.2009**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1, nenit 45, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “P”, 5 pika 1 germa “P”, 12, 13, 14 pika 1 dhe nenit 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /te pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.9.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. për



rinovimin e licencës së furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9 pika 4/9 germat a,b dhe c) janë plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 102, datë 21.12.2009.

2. Ky vendim hyn në fuqi më 21.12.2014 dhe i shtrin efektet e tij për një periudhë 5-vjeçare.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 85, datë 16.9.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “A&A GROUP” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa “a”, 9, 13 pika 1 germa “ç”, 45 pikat 3 dhe 4, dhe 48, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve
Faqe | 8156

4 pika 1 germa “P”, 5 pika 1 germa “P”, 8, 10 pika 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.9.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “A&A Group” sh.p.k. , si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

KONSTATOI SE :

Aplikimi i shoqërisë “A&A Group” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b”, “c”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “A&A Group” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja “Kristalina”
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 16 lekë